

# PETICION

**Drejtuar :** **Shkëlqesisë së Tij** Z. EDI RAMA, Kryeministër

Znj. Mirela Kumbaro, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Z. Zamir Dedej, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

Z. Spiro Maliqi, Prefekti i Qarkut Elbasan / Kryetar i ABU Shkumbin

Z.Nuri Belba, Kryetar i Bashkisë Prrenjas

## **I nderuar Z.Kryeministër :**

Jemi të vetëdijshëm ndaj planit të ndërtimit të “Hec Bushtrica 3” në shtratin e lumit Bushtrica i cilit shtrihet në dy njësitë vendore ; Rrajcë dhe Qukës, Bashkia Prrenjas, lumë i cili buron nga Liqenet akullnajore të Rrajcës dhe brenda zonës qëndore (strikte) të parkut kombëtare Shebenik-Jabllanicë (Kategoria e II-të “Park Kombëtare” sipas IUCN –International Union for Conservation of nature).

Jemi mjaft të shqetësuar mbi procedurat e nisura për dhënien e lejes për ndërtim Hec-e në trupin e lumit Bushtrica, për arsye se ndërtimi i tyre do të ketë ndikim të drejtëpërdrejtë në mirëqënien dhe cilësinë e jetës të komunitetit të zonës dhe do të dëmtonte në mënyre të pakthyeshme ekosistemin e tij.

Lumi Bushtrica është një nga lumejtë më të vjetër të Eurpoës me iktifaunë mjaft të pasur, ku ndër të tjera përmendim troftën e egër e cila listohet në librin e kuq si një specie në rrezik zhdukjeje. Për më tepër lumi bushtrica buron në zonën UNESCO, listuar së fundmi si pjesë e trashëgimisë botërore për pyjet e vjetra të ahut. Gjithashtu kjo zonë përfshihet edhe në Brezin e Gjelbërt të Europës, si edhe në harkun e Parqeve Dinarike të Evropës, duke shtuar kështu rëndësinë e ruajtjes dhe mbrojtjes së saj.

Në pjesën e poshtme të lumit Bushtrica gjithashtu çenohet dhe Kanioni i Menikut i cili është një destinacion turistik i rëndësishëm. Mbi këtë kanion ndodhet edhe “Ura e Prenit” një urë e vjetër antike që mendohet të jetë e shekullit XV.

Nëpërmjet këtij peticioni, kërkojmë nga ju që të anulohet procedurat e dhënies së lejes për ndërtimin e Hec-ve mbi lumin Bushtrica, pasi dhënie e lejes bie ndesh me legjislacionin shqiptarë,ndërkombëtar si edhe të një numëri të madh konventash të ratifikuar nga shteti Shqiptar, duke shkëlur specifikisht edhe ligjin nr. 81/2017 për Zonat e Mbrojtura (pjesa e sipërme e lumit) por edhe pjesa e poshtme e lumit çenon rëndë ekzistencën natyrore të këtij lumi.

**Sinqerisht,**

**Lista e organizateve te shoqërisë civile,ekspertë dhe përfaqesues nga komuniteti lokal.**

Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri




Shoqata e Bashkuar Agro-Mjedisore "Agri-En"

Shoqata MEDAPAK




Shoqata "EGNATIA"

Shoqata "AlbNatyra"



Shoqata e Bletarëve  
LIBRAZHD  
veli Hoxha

Shoqata "Barazi dhe integriteti"  
Rexhep Shpresa



S.H.P.P.K.K. Qendres  
Kryetari  
Mekencen Memet

Shoqata ACS  
Felix Balliu

Signature of the representative of the 'Klubi Ekologjik Elbasan'.



Klubi Ekologjik Elbasan  
Kryetari  
Ahmet Mehmeti

Ekspert Mjedisor  
ing. Hasan Deliu  
Deliu

MSC. Jnxh. Mjedisit  
Migena Kukpi  
Signature




Elb. me 10.10.2021  
Signature

## KESHILLI FSHATIT QUKES SHKUMBIN

fshati qukes shkumbin i perbere me nje nr . Rreth 2000 banore afersisht 400 familje, dhe me nje siperfaqe toke produktive 250 hektarësh e cila vaditet me ujin e lumit BUSHTRICE i cili eshte jetik per keto familje si per bujqesine edhe per blektorine per gjate gjithë vitit : nuk eshte dokort qe ky uje te kanalizohet per ndertim HEC.


Ky vendim merret nga 7 antaret e keshillit te cilet jane perfaqesuesit e lagjeve perkatese.

Kryetari i fshatit XHEVIT KUSHTA




### ANETARE


1 Selim kryeziu




2 Bedri kushta




3 Qani shyti



4 Adem loshi



5 Artan kala



6 Xhevit marta

